



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT K R Y E T A R I

Nr. 355/27 Prot.

Tiranë, më 23/12/2016

### V E N D I M Nr. 155, Datë 23/12/2016

#### **MBI MIRATIMIN E RAPORTIT TË KONTROLLIT TË CILËSISË TË USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL FIER NË BAZË TË URDHRI TË KRYETARIT TË KLSH-së ME NR. 128, DATË 20.10.2016.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Kontrollit të Cilësisë të Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Përgjithshëm, Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, Drejtori i Departamentit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike si dhe Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Cilësisë vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit në mbështetje të nenit 10 dhe 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

### V E N D O S A:

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit: “Për Kontrollin e Cilësisë mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko financiar në Spitalin Rajonal Fier”.

Shqyrtimi i dosjes së auditit u bë në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të KLSH me nr. 128, datë 20.10.2016 “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e sigurimit të cilësisë së dosjes së auditimit të ushtruar në Spitalin Rajonal Fier”, programit të auditimit nr. 350/19, datë 20.10.2016 me objekt auditimi: “Për Kontrollin e Cilësisë mbi zbatimin e ligjshmërisë, për Spitalin Rajonal Fier dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiar”, audituar për periudhën 01.01.2013 deri më 30.03.2016, duke u përqendruar veçanërisht në çështjet e trajtuara në ankesat e ardhura nga punonjësit e Spitalit Rajonal Fier, përkatësisht me nr. 787/52, datë 17.10.2016 nga ish-punonjësja ■■■ dhe me nr. 350/16, datë 14.10.2016, nga punonjësja ■■■ si dhe pretendimet e ngritura nga ish-Drejtori ■■■ në ballafaqimin e fundit të zhvilluar në KLSH më datën 30.09.2016.

Qëllimi i këtij kontrolli ishte vlerësimi i punës audituese si dhe respektimi i standardeve të auditimit nga grupi i përfshirë në këtë mision auditimi.

Grupi i Kontrollit të Cilësisë në procesin auditues u përqendrua kryesisht në zbulimet dhe konstatimet të evidentuara dhe të raportuara nga grupi i auditimit, mbështetjen dhe argumentimin ligjor dhe me dokumente shkresore të tyre, shqyrtimin dhe pasqyrimin e observacioneve të bëra nga

punonjësit e Spitalit Rajonal Fier, për procesverbalet, aktverifikimet, Projekraportin e Auditimit, dhe ankesat e ardhura pas dërgimit të Projekraportit të Auditimit.

Në përfundim të këtij procesi rezultoi se krahas punës voluminoze të bërë në drejtim të auditimit (zbulimeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve), në procesin e zbatimit dhe përfundimit të kontrollit të kësaj dosje u konstatuan të meta e mangësi në zbatim të kërkesave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Standardet e Auditimit të KLSH.

**II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:**

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

Mbështetur në nenin 27, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 15, 21, 23, 41 dhe 42 i ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier për vlerat e mëposhtme të mos të nxirren aktet administrative për shpërblim dëmi dhe konkretisht:

**Gjetje nr. 1: Në ankesën me nr. 787/52, datë 17.10.2016 nga ish punonjësja ■ dhe ankesës me nr. 350/16, datë 14.10.2016 të punonjësës ■, janë ngritur këto pretendime:**

- Në procedurën “*Blerje medikamente*” është mbajtur procesverbali nr. 44, për rritje fiktive të çmimit të disa medikamenteve me dëm ekonomik në vlerën 1,294,890 lekë, vlerë cila i është ngarkuar për zhdëmtim anëtarëve të Njesisë së Prokurimit ■, ■ dhe ■.

Sipas pretendimeve të ish-punonjësës, ky dëm nuk ekziston për arsye se ndryshimi i çmimit të medikamenteve është kryer duke marrë për bazë çmimet tavan të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

- Nga Grupi i Kontrollit të Cilësisë, u kontrollua procedura e prokurimit: “Blerje Medikamente”, me procedurë “Negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”, nga ku rezultoi si më poshtë:

Në referencë të letrave të punës dhe materialeve të administruar në dosje u konstatua që pretendimi i ish-punonjësës është i drejtë. Njësia e Prokurimit në ripërllogaritjen e fondit limit është bazuar në çmimet e Ministrisë së Shëndetësisë.

Ajo që ka çuar grupin e auditimit në konkluzionin e dëmit ekonomik është se ky i fond limit duhet të ishte llogaritur që në fillim sipas Udhëzimit të Ministrisë së Shëndetësisë. Veprimi i Njesisë së Prokurimit për të devijuar nga ky udhëzim ka çuar në anulimin e procedurave të mëparshme duke justifikuar kështu përdorimin e procedurës “Me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit” dhe për pasojë ka shmangur konkurrencën për të ulur kostot e realizimit të objektit të prokuruar.

Sa më lart shmangia e tenderit të hapur dhe realizimi me procedurën e mësipërme janë veprime të rënda dhe ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e Njesisë së Prokurimit të cilët kanë përcaktuar çmime më të ulëta se çmimet e MSH, tendera këto të anuluar (mbase dhe të qëllimshme për të çuar në dështimin e procedurës së mëparshme dhe për të shkuar tek procedura me negocim pa shpallje paraprake), por dëmi ekonomik nuk ka bazë ligjore për tu zhdëmtuar.

***Sa më lart rekomandojmë:***

**1.** Revokimi i pikës 3, germa B-Masa për shpërblim dëmi, për vlerën prej 1,294,890 lekë, të dërguar me shkresën nr. 850/15, datë 05.10.2016 “Dërgim Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet”, duke zbatuar masat disiplinore të përcaktuara në shkresën e mësipërme.

**Menjëherë**

**Gjetje nr. 2: Në ankesën me nr. 787/52, datë 17.10.2016 nga ish punonjësja ■ janë ngritur këto pretendime:**

-Në tenderin e zhvilluar me procedurë: “Negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”, të zhvilluar me objekt: “Blerje Kite, Reagent dhe materiale konsumi”, në procesverbalin e mbajtur nga grupi i auditimit me nr. 23/1, datë 16.05.2016 trajtohet se: *Si pasojë e përdorimit të procedurës së prokurimit: “Negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”, llogaritjes më tepër të fondit limit dhe zhvillimit formalisht të procedurës së prokurimit, është krijuar një dem buxhetit të shtetit në vlerën 912,640 lekë, veprim që ngarkon me përgjegjësi z. ■■■, znj, ■■■ dhe znj. ■■■ anëtarë të Njësisë së prokurimit.*

*Njësia e Prokurimit përbëhet nga 4 persona dhe nga grupi i auditimit është përjashtuar ■■■.*

- Nga grupi i Kontrollit të Cilësisë, u auditua procedura e prokurimit: “Blerje Kite, Reagent dhe materiale konsumi”, me procedurë “Negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”, nga ku rezultoi si më poshtë:

- Nga spontimi i personave përgjegjës të përcaktuar në procesverbal, Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe shkresës së mësipërme Dërgim Raporti Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet, rezulton se znj. ■■■ (anëtare e Njësisë së Prokurimit) e përcaktuar si person përgjegjës në procesverbal, është hequr nga përgjegjësia në Projektraport dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit. Veprimi i grupit të auditimit bie në kundërshtim me Standardet e Auditimit në KLSH dhe ligjin nr. 10294, datë 01.07.2010 “Për inspektimin financiar publik”, aktualisht i shfuqizuar i cili në nenin 22-përgjegjësia për shkaktimin e dëmit, në pikën 2 të përcakton shprehimisht: *“Në rast se dëmi është shkaktuar nga disa individë, ata vendosen bashkë përpara përgjegjësive, në bazë të dispozitave të Kodit Civil”*, të përcaktuara edhe në nenin 618 të këtij kodi.

- Nga kontrolli i zhvillimit të procedurave të tenderit të mësipërm rezultoi se grupi i auditimit ka vepruar drejtë për arsye se nga zhvillimi i tenderit rezulton një dem ekonomik prej **912,000 lekë pa t.v.sh.** i shkaktuar nga llogaritja e fondit limit dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e Njësisë së Prokurimit ■■■, ■■■, ■■■ dhe ■■■.

- Duke krahasuar çmimet e përcaktuara në llogaritjen e fondit limit të artikujve me çmimet e kontratës së lidhur në vitin e mëparshëm, rezulton një diferencë prej rreth 912,000 lekë pa t.v.sh. ose 43 % të fondi limit. Si rregull nga ana e Njësisë së Prokurimit në përcaktimin e çmimeve sipas artikujve, duhet të ishte mbështetur në çmimet e kontratës së vitit të kaluar, për arsye se nuk justifikohet rritja 2-3 herë më e madhe e ofertave për disa artikuj të dhëna nga Operatorët Ekonomikë të negociuar.

#### ***Sa më lart rekomandojmë:***

**1.** Në pikën 4, germa B- Masa për shpërblim dëmi, për vlerën prej 912,640 lekë, si dhe në germën C- Masa disiplinore, të dërguar me shkresën nr. 850/15, datë 05.10.2016 “Dërgim Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet”, të shtohet edhe anëtare e Njësisë së Prokurimit ■■■.

**Menjëherë**

#### **Gjetje nr. 3: Në ankesën me nr. 350/16, datë 14.10.2016 të punonjëse ■■■, janë ngritur këto pretendime:**

Në tenderin “Rikonstruksion i rrjetit të oksigjenit të Spitalit Rajonal Fier”, me procedurë “Kërkesë për Propozim”, ku pretendohet se:

**a.** *Nga grupi i auditimit nuk është mbajtur procesverbal me anëtarët e Njësisë së Prokurimit (■■■, ■■■ dhe ■■■), por janë ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit ku është lënë për zhdëmtim vlera prej 615,340 lekë nga ■■■, ■■■, ■■■ dhe ■■■.*

**b.** *Në fondin limit nuk është llogaritur dy herë t.v.sh. pasi në ofertat e marra nga tre OE që është kryer testimi i tregut për llogaritjen e fondit limit nuk ka qenë e përfshirë t.v.sh..*

- Nga grupi i Kontrollit të Cilësisë, u auditua procedura e prokurimit “Rikonstruksion i rrjetit të oksigjenit të Spitalit Rajonal Fier”, nga ku rezultoi:

Nga grupi i auditimit nuk është mbajtur procesverbal me anëtarët e Njësisë së Prokurimit (■■■■ dhe ■■■■), dhe ato janë ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit ku është lënë për zhdëmtim vlera prej 615,340 lekë nga ■■■■, ■■■■ dhe ■■■■.

Sa më lart nga grupi i auditimit është vepruar në kundërshtim me Standardet e Auditimit.

- Nga auditimi i kësaj procedure nga grupi i kontrollit të cilësisë rezulton se Fondi Limit i përcaktuar është pa t.v.sh. dhe nuk qëndron gjetja e grupit të auditimit se është llogaritur dy herë vlera e t.v.sh., pasi në ofertat e marra nga studimi i tregut nuk ka qenë e përfshirë t.v.sh.

*Për këtë u kontrollua dokumentacioni përkatës nga ku rezultoi:*

- Në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 9-Llogaritja e vlerës së kontratës”, pika 1, përcakton shprehimisht: Vlera limit e kontratës publike është shuma totale, pa t.v.sh.

- Nga kontrolli i çmimeve të përcaktuara në preventiv dhe situacion me deklaratat doganore ( nr. R 39352 Manifesti) rezultoi se çmimet në preventiv dhe situacion (para llogaritjes së t.v.sh.) janë të llogaritura dhe të vendosura pa t.v.sh. Ky fakt argumentohet edhe me vendosjen e bazës së taksueshme prej 350,000 lekë para llogaritjes së t.v.sh-së në doganë, të deklaruara në faturat doganore dhe vlerën prej 364,000 lekë të vendosur në ofertë ose 10.4 % më shumë se vlera e taksueshme në doganë.

- Në fakt “Instalimi i Aparaturave dhe Rikonstruksioni i Rrjetit të oksigjeneve të Spitaleve”, si dhe Instalime të tjera si Pajisje Informatike, Radiostacione Antena TV, Kondicioner etj nuk përfshihen në VKM nr. 568, datë 27.06.2013 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, në Manualin 4-Analiza teknike për punimet dhe instalimet teknologjike.

**Sa më lart rekomandojmë:**

1. Revokimi i pikës 7, germa B - Masa për shpërblim dëmi, për vlerën prej 615,340 lekë, të dërguar me shkresën nr. 850/15, datë 05.10.2016 “Dërgim Raporti përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet”.

#### Menjëherë

**Gjetje nr. 4:** Në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesën me nr. 350/12, datë 29.09.2016 nga znj. ■■■■ si dhe pretendimet e ngritura në ballafaqimin e kryer më datën 30.09.2016 se mbi procedurat e prokurimit dhe tenderat e audituar për periudhën që ka qenë titullare e AK nga grupi i auditimit është kryer auditim i plotë.

Nga Grupi i Punës i Kontrollit të Cilësisë u ushtrua kontroll mbi gjithë tenderat e zhvilluar nga AK si dhe gjithë tenderat e audituar nga grupi i auditimit dhe rezultoi sipas pasqyrës së mëposhtme:

Nr Rend	Emër Mbiemër	Data e Emërimit	Data e Largimit	Muaj	Tenderë të zhvilluar	Tenderë të audituar	Tenderë të audituar në %
1	■■■■		10.04.2013	3.3	48	16	33.3
2	■■■■	11.04.2013	19.11.2013	7	14	4	28.6
3	■■■■	20.11.2013	14.05.2015	18	57	31	54.4
4	■■■■	15.05.2015	11.08.2015	3	1	1	100.0
5	■■■■	12.08.2015	29.03.2016	6.5	28	10	35.7

**Konkluzion:** Sipas pasqyrës së mësipërme rezulton se nga grupi i auditimit është përcaktuar qartë risku në prokurime dhe ka një auditim pothuajse me përqindje të rregullt sipas periudhës së çdo titullari të Autoritetit Kontraktor.

Ankesa e znj. ■■■■ për auditimin 100 % të tenderëve për periudhën që ajo ka qenë titullare e AK nuk qëndron.

### **Gjetje nr. 5: Të tjera nga Kontrolli i Cilësisë:**

Nga grupi i auditimit për vitet 2013,2014, 2015 dhe 3-mujori i parë i vitit 2016 rezulton se janë audituar 21 procedura me: “Negocim pa botim paraprak të njoftimit”, me një vlerë fondi limit prej 49,188,570 lekë dhe lidhur kontrata për 49,054,838 lekë, ose 133,732 lekë më pak me një përqindje realizimi 99.7 % fondi i realizuar në raport me fondin limit.

*Për sa më sipër nxjerrim këto konkluzione:*

**Së pari:** AK ka vepruar në kundërshtim me bazën ligjore në fushën e prokurimeve dhe konkretisht:

a. Me nenin 33 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

b. Me kreun IV, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

c. Me VKM nr. 32, datë 23.01.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 1, datë 10.01.2017 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar,

d. Me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;

**d.1.** Nga Spitali Rajonal Fier nuk është zbatuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, neni 70-ku përcaktohet shprehimisht: *“Zhvillimi i procedurës së prokurimit do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 21, të këtyre rregullave, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogaritë përkatëse) të autoritetit kontraktor”.*

**Së dyti:** Ligji nr. 8756, datë 26.03.2001 “Për emergjencës civile”, përcakton qartë kuptimin e emergjencave civile.

Nga ballafaqimi i kryerjes së realizimit të procedurës së mësipërme me ligjin e mësipërm rezulton se procedura e kryer për tenderët nga AK SRF me procedurë “Negocim pa botim paraprak të njoftimit”, nuk përputhen me fenomenet e përcaktuara në këtë ligj, si dhe përcaktimin e masave mbrojtëse, organizative, teknike dhe çdo masë tjetër për mbrojtjen e menjëhershme individuale dhe kolektive të njerëzve, ose operacion ndërhyrje për shpëtimin e jetës së njerëzve në një territor të prekur nga fatkeqësia, si dhe sigurimi i kushteve për jetesë të popullatës të prekur nga fatkeqësia.

**Së treti:** Detyrat dhe funksionet e Drejtorisë së Spitalit janë përcaktuar në mënyrë analitike në Rregulloren e Brendshme dhe në Rregullat e Funksionimit Ekonomiko-Financiar të SRF. Drejtorët e Spitalit në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, i kanë patur të gjitha mundësitë financiare e kohore për të përdorur këto procedurë prokurimi në përputhje me rregullat e prokurimit publik.

Emergjenca për nevojat e mësipërme nuk janë shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara, por nga vetë Autoriteti Kontraktor, i cili nuk ka marrë masat e duhura për të planifikuar sa më drejtë dhe zhvillimin e tenderit me specifikime teknike sipas Standardeve Shtetërore.

Shmangia e procedurave standarde të prokurimit, me pretekstin e nevojave emergjente, ka krijuar premisa për shmangien e konkurrencës dhe pengimin e hyrjes në treg të shumë operatorëve ekonomike që operojnë në këto tregje.

**Së katërti:** Shmangia e procedurave standarde të prokurimit, me pretekstin e nevojave emergjente, ka krijuar premisa për shmangien e konkurrencës dhe pengimin e hyrjes në treg të shumë operatorëve ekonomike që operojnë në këto tregje.

**Së pesti:** Njëkohësisht edhe kryerja e procedurave të mësipërme “Me negocim pa shpallje”, është kryer në kundërshtim me nenin 33, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, pikës 5, të Kreut IV të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, aktualisht i shfuqizuar, nenin 36 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, për arsye se nga autoritetit kontraktor është lejuar **shkelje e barazisë në tenderë dhe copëtim të fondeve.**

**Së gjashti:** Për sa trajtuam më sipër nuk është zbatuar dhe neni 1- Objekti dhe qëllimi, i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht:

*“a) të rrisë efincencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;*  
*b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*  
*c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*  
*ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*  
*d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*  
*dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.*

**Sa më lart rekomandojmë:**

1. Nga Spitali Rajonal Fier të merren të gjitha masat në mënyrë që të gjitha kërkesat që do të kryhen për medikamente, materiale mjekimi, kite dhe reagente, materiale konsumi si dhe nevojave për mirëmbajtje të jenë të argumentuar mbi bazën e hartimit të bilanceve materiale për gjendjen e mallrave në magazinë, konsumet mesatare mujore, domosdoshmërinë për kryerjen e shërbimeve e tjera, si dhe të merren të gjitha masat për organizimin e procedurave të tenderëve duke shmangur në maksimum procedurën ‘Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit’, duke zbatuar me përpikmëri të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e prokurimeve si dhe urdhrin e Ministrisë së Financave nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

**Vazhdimisht**

2. Nga Ministria e Shëndetësisë të kryhet auditim në Spitalin Rajonal Fier duke kryer auditim të plotë për të gjitha procedurat “Me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”.

**Brenda 3-mujorit të parë 2017**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës dhe Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**



## **KONTROLLI I LARTË I SHETIT K R Y E T A R I**

---

Nr. 108/7 Prot.

Tiranë, më 28.12.2016

### **VENDIM I NDËRMJETËM**

#### **PËR MIRATIMIN E REZULTATEVE TË KONTROLLIT TË SIGURIMIT TË CILËSISË NË TË FTOHTË TË AUDITIMIT TË INICIUAR NË “SPITALIN RAJONAL FIER” NË BAZË TË PROGRAMIT TË AUDITIMIT NR. 350/19, DATË 20.10.2016**

Pasi u njoha me rezultatet e kontrollit të sigurimit të cilësisë në të ftohtë të iniciuar në bazë të Urdhrit të Kryetarit të KLSH nr. 128, datë 20.10.2016 në lidhje me auditimin e zhvilluar në “Spitalin Rajonal Fier” sipas programit të auditimit nr. 350/19, datë 20.10.2016, si dhe konfirmimin e dhënë Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, Drejtori i Përgjithshëm dhe Sekretari i Përgjithshëm, mbështetur në nenin 10 dhe 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

#### **V E N D O S A:**

- I.** Të miratoj rezultatet e kontrollit të sigurimit të cilësisë në të nxehtë, paraqitur nga grupi i kontrollit të sigurimit të cilësisë i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.
- II.** Rezultatet e kontrollit të sigurimit të cilësisë në të ftohtë të dalin me një Raport dhe Vendim të veçantë Auditimi.
- III.** Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim, ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike, si dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

**K R Y E T A R**

**Bujar LESKAJ**